

Udhëzime për ngarkimin dhe shkarkimin e mallit të vendosur në paleta Shqip	141 101 1120DO Nr. i versionit: 0.06 17 korrik 2007
--	---

Udhëzime të përshtatshme për të gjithë drejtuesit e mauneve

1. Në rast katastrofë: ndiqni menjëherë udhëzimet nga personeli i SABIC-ut.
2. Vetëm drejtuesi mund të hyjë në vendndodhje.
3. Pasi të merrni dokumentet e ngarkimit/shkarkimit, duhet të shkoni menjëherë në vendin e ngarkimit.
4. Kur gjendeni jashtë kabinës duhet të keni veshur kapele sigurie, këpucë sigurie, doreza, jelek sigurie (fluoreshent) dhe rroba pune që mbulojnë plotësisht në çdo kohë krahët dhe këmbët tuaja.
5. Motori duhet të jetë i fikur gjatë ngarkimit.
6. Drejtuesi duhet ta hapë plotësisht njërën anë të maunes në anën e drejtuesit.
7. Gjatë shkarkimit të arkave të ambalazhit, maunia duhet të jetë e hapur në të dyja anët.
8. Përdorni shkallë me rrota kur hapni dhe mbyllni mushamatë dhe gjatë heqjes dhe rivendosjes së dërrasave; pasi ta keni përdorur, kthejeni shkallën në vendin e planifikuar.
9. Pasi ta hapni maunen, prisni në kabinë që të ngarkohet.
10. Nuk lejoheni të ecni në asnjë moment nëpër depo.
11. Gjatë ngarkimit pa rripa shtrëngues, drejtuesi duhet të jetë brenda në kabinë ose ngjitur me të.
12. Gjatë ngarkimit me rripa shtrëngues, drejtuesi i mjetit duhet të qëndrojë 5 metra larg nga vinçi pirun në maune.
13. Kur ngarkimi zhvillohet në vende të ndryshme, mushamatë duhet të mbyllën dhe të sigurohen në kohën e ndërmjetme. Nuk lejohet në asnjë moment të drejtoni mjetin kur mushamatë janë të palidhura.
14. Nëse dëshironi që paletat ose arkat tetëkëndëshe të ngarkohen në një mënyrë tjetër dhe jo dy nga dy pranë njëra-tjetrës, luteni të informoni drejtuesin e vinçit pirun. Në atë rast duhet të lidhni me rripa shtrëngues çdo rresht.
15. Pas ngarkimit, duhet të shkoni menjëherë përsëri në dritaren e receptionit që të raportoni për dokumentet.

Udhëzime shtesë kur përdoret ura e ngarkimit ose platforma e ngarkimit:

1. Platforma e ngarkimit: tërhiqni frenin e dorës dhe (me përjashtim të platformave të ngarkimit me bllokim automatik të rrotave) futni takot dhe jepjani çelësin e kuadrit drejtuesit të vinçit pirun.
2. Ura e ngarkimit: Tërhiqni frenin e dorës, lidhni konteinerin me urën duke përdorur zinxhirë, futni takot, bllokoni suspensionin ose vendoseni në pozicionin më të ulët të tij dhe jepjani çelësin e kuadrit drejtuesit të vinçit pirun.

Udhëzime shtesë gjatë ngarkimit të rimorkios me platformë.

1. Pas ngarkimit, produkti duhet të mbulohet plotësisht nga mushamatë. Kjo duhet bërë në impiantin e mbulimit me mushama në depon 7.
2. Gjatë transportit për në impiantin e fiksimit të mushamasë, duhet të lidhni rreshtin e parë dhe të fundit të paletave duke përdorur një rrip tendosës.

Ngarkimi do të ndalohe, nëse nuk i respektoni udhëzimet e mësipërme.

Emri:

Data:

U lexua dhe u kuptua (nënshkrimi):

Udhëzime për ngarkimin e materialeve të paambalazuara Shqip	141 101 1120DO Nr. i versionit: 0.06 17 korrik 2007
--	---

Udhëzime të vlefshme për të gjithë drejtuesit e mauneve:

1. Në rast katastrofe: ndiqni menjëherë udhëzimet nga personeli i SABIC-ut.
2. Vetëm drejtuesi mund të hyjë në vendndodhje.
3. Pasi të merrni dokumentet e ngarkimit/shkarkimit, duhet të shkoni menjëherë në vendin e ngarkimit.
4. Kur gjendeni jashtë kabinës duhet të keni veshur kapele sigurie, këpucë sigurie, doreza, jelek sigurie (fluoreshent) dhe rroba pune që mbulojnë plotësisht në çdo kohë krahët dhe këmbët tuaja.
5. Vendet ku duhen vendosur mbrojtëse për veshët tregohen me shenja.
6. Qëndroni shumë pranë maunes (me përjashtim të rasteve kur ka ndodhur avari, kjo i duhet raportuar menjëherë personelit të SABIC-ut).
7. Lexoni me kujdes dhe ndiqni udhëzimet fotografike për mënyrën e ngarkimit (që disponohen në vend).
8. Pasi të jetë ngarkuar çdo pjesë nëpërmjet një kapaku mbushës, koshi mbushës duhet zhvendosur në pozicionin e tij më të lartë.
9. Nëse gjatë ngarkimit ndodh një gabim, ai duhet raportuar menjëherë në dritaren e recepsionit dhe maunia me mallin e paambalazhuar nuk duhet lëvizur.
10. Shkalla e palosshme në maunen me mall të paambalazhuar duhet përdorur në pozicionin e palosur.
11. Hyrja dhe dalja nga maunia me mall të paambalazhuar duke përdorur shkallën, duhet bërë duke u mbajtur tek këmbëzat horizontale dhe JO tek "boshtet" vertikale.
12. Nuk lejohen persona të tjerë në maunen me mallra të paambalazhuar kur është duke udhëtuar.
13. Hapni çdo herë nga një kapak mbushës që të shmanget ndotja.
14. Produkti i derdhur duhet raportuar në dritaren e recepsionit.
15. Koshi mbushës nuk duhet ndërprerë.

Udhëzime shitesë për ngarkimin e konteinerëve

1. Për të hyrë në konteiner, përdorni shkallën që mund të gjendet aty dhe pas përdorimit kthejeni në vendin e planifikuar. Konteineri duhet të qëndrojë gjithmonë prapa shasisë. Lexoni me kujdes dhe ndiqni udhëzimet fotografike për përdorimin e shkallës (gjenden në vend).
2. E gjithë puna në konteiner duhet të zhvillohet vetëm në rruginën midis mallit.
3. Ndalohet vendosja e këmishëve të konteinerit në zonën e Chemelot, duke përfshirë edhe parkingët e automjeteve në afërsi të portës, nga jashtë.

Ngarkimi do të ndalohet, nëse nuk i respektoni udhëzimet e mësipërme.

Emri:

Data:

U lexua dhe u kuptua (nënshkrimi):